

RAPORTI I VLERËSIMIT TË NDIKIMIT	
EMËRTIMI I PROPOZIMIT TË POLITIKËS	Projektligj “Për identifikimin elektronik shërbimet e besuara dhe portofolin e identitetit digjital”
MINISTRIA UDHËHEQËSE	Kryeministria ...
FAZA E POLITIKËS/VLERËSIMIT TË NDIKIMIT	Finale
BURIMI I PROPOZIMIT TË POLITIKËS	Transpozim i Rregullores së BE -së
DIREKTIVË/RREGULLORE E BE-së	Rregullore (BE) Nr.910/2014 e Parlamentit Evropian dhe të Këshillit e dates 23 korrik 2014 “Mbi Identifikimin elektronik dhe shërbimet e besuara për transaksionet elektronike në tregun e brendshëm, dhe shfuqizimin e Direktivës 1999/93/KE” Rregullore nr. 2024/1183 e Parlamentit Evropian dhe Këshillit të datës 11 Prill 2024, që ndryshon Rregulloren (BE) Nr. 910/2014 lidhur me krijimin e Identitetit Digjital Evropian
PUBLIKIMET DHE STRATEGJITË E LIDHURA	Jo
DATA E KONSULTIMIT PUBLIK	3. 6. 2025- 30.6.2025
DATA E VLERËSIMIT TË NDIKIMIT	27/03/2026
A E KA SHQYRTUAR KRYEMINISTRIA VLERËSIMIN E NDIKIMIT? NËSE PO, JEPNI DATËN E SHQYRTIMIT	Po Dërguar për shqyrtim në Kryeministri me shkresën nr. 2807 prot., date 25.10.2025.
NUMRI I VLERËSIMIT TË NDIKIMIT	2026 – AKSK – Nr. 1
TE DHËNA KONTAKTI (EMRI, E-MAIL, NUMRI I TELEFONIT TË PERSONIT TË KONTAKTIT)	Oltjana Beci +35542221039 oltjana.beci@aksk.gov.al Arjona Bello +35542221039 arjona.bello@aksk.gov.al
PJESA 1: PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE (maksimumi 2 faqe)	
PËRKUFIZIMI I PROBLEMIT <i>Cili është problemi në shqyrtim dhe cilat janë shkaqet e tij? Jepni arsyet e nevojës së ndërhyrjes së qeverisë. (jo më shumë se 10 rreshta)</i>	

Problemi lidhet me nevojën për përditësimin e kuadrit ligjor aktual lidhur me identifikimin elektronik dhe shërbimet e besuara si nënshkrimin elektronik, vulat elektronike, shërbimin elektronik të kualifikuar të regjistruar dhe autentifikimin e faqeve të internetit në Republikën e Shqipërisë dhe shërbimeve të tjera të besuara sipas përcaktimeve të legjislacionit të BE në këtë kuadër.

Shihet e nevojshme angazhimi i qeverisë në përmirësimin e ofrimit të shërbimeve të besuara (si nënshkrimi elektronik, vulat elektronike, vulat kohore elektronike, shërbimin elektronik të regjistruar të transmetimit, autentifikimin e faqeve të internetit, arkivimin elektronik dhe vërtetimin elektronik të attributeve, menaxhimin e pajisjeve të krijimit të nënshkrimit elektronik, menaxhimin e pajisjeve të krijimit të vulës elektronike dhe regjistrat elektronikë) duke bërë të mundur një qasje më të lehtë dhe më të shpejtë në shërbimet e ofruara nga ofruesit e kualifikuar të shërbimit të besuar, me qëllim garantimin e besueshmërisë dhe sigurisë në përdorimin e shërbimeve të identifikimit elektronik dhe shërbimeve të besuara nga qytetarët, bizneset dhe administrata publike, për të hyrë në shërbimet online ose për të menaxhuar transaksionet elektronike në vend.

Problematikat kryesore të identifikuar mund të përmbliidhen si më poshtë:

- Mungesa e dispozitave lidhur me portofolin e identitetit digjital si dhe identifikimin elektronik në distancë (remote) apo të metodave të tjera ekuivalente me prezencën fizike për një identifikim elektronik sa më të sigurt;
- Mungesa e dispozitave në kuadrin ligjor të identifikimit elektronik dhe shërbimeve të besuara për sa i përket njohjes reciproke si dhe ndërveprimit të skemave të identifikimit elektronik/portofolave të identitetit digjital në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar.
- Mungesa e rregullimeve për sigurinë në rastet e shkeljes ose komprometimit të skemave apo portofolave të identitetit digjital;
- Mungesa e parashikimeve lidhur me certifikimin e pajisjeve të krijimit të nënshkrimeve elektronike të kualifikuara dhe vulave elektronike të kualifikuara çon në vështirësi për garantimin e sigurisë dhe besueshmërisë në ofrimin e këtyre shërbimeve të besuara.
- Mungesa e dispozitave që rregullojnë shërbimin e kualifikuar të ruajtjes së nënshkrimeve/vulave elektronike të kualifikuara si dhe shërbimin e kualifikuar të vërtetimit të vlefshmërisë së nënshkrimeve/vulave elektronike të kualifikuara duke rritur besueshmërinë e nënshkrimit elektronik të kualifikuar përtej periudhës së vlefshmërisë teknologjike.

Plotësimi i kuadrit ligjor në këtë drejtim është detyrim i vendit edhe në kuadër të procesit të integritit evropian. Plani Kombëtar i Integritit Evropian të Republikës së Shqipërisë (2025-2027) ka parashikuar transpozimin e Rregullores (BE) Nr.910/2014 e Parlamentit Evropian dhe të Këshillit e datës 23 korrik 2014 “Mbi identifikimin elektronik dhe shërbimet e besuara për transaksionet elektronike në tregun e brendshëm, dhe shfuqizimin e Direktivës 1999/93/KE” dhe Rregullores nr. 2024/1183 e Parlamentit Evropian dhe Këshillit të datës 11 Prill 2024, që ndryshon Rregulloren (BE) Nr. 910/2014 lidhur me krijimin e Identitetit Digjital Evropian.

Gjithashtu miratimi i legjislacionit për identifikimin elektronik dhe shërbimet e besuara i përafuar me Rregulloren eIDAS 1&2 është i përfshirë edhe në reformat e përcaktuar në dokumentin Growth Plan (Vendimi nr. 621, datë 10.10.2024 “Për miratimin e dokumentit të politikës “Agjenda Kombëtare e Reformave 2024–2027”, në kuadër të instrumentit të Bashkimit Evropian “Faciliteti për Reforma dhe Rritje për Ballkanin Perëndimor).

Marrë në konsideratë detyrimet e shtetit shqiptar në kiuadër të procesit të integritit evropian si dhe zhvillimet teknologjike të fushës dhe risitë e sjella nga kjo rregullore të tilla si politika e Portofolit të Identitetit Digjital, përcaktimet lidhur me shërbimet e besuara, ofruesit e shërvimeve të besuara etj, të cilat janë thelbësore dhe të domosdoshme për tu përfshirë në legjislacionin aktual për identifikimin elektronik dhe shërbimet e besuara, nga ana e Autoriteti filloi procesi i ripunimit të projektligjit “Për identifikimin elektronik dhe shërbimet e besuara”, me qëllim përafrimin me rregulloren eIDAS2.

OBJEKTIVAT

Cilat janë objektivat dhe rezultatet e synuara të propozimit? (jo më shumë se 7 rreshta)

Objektivat që synohen të arrihen janë:

- Rritja e sigurisë për transaksionet elektronike në vend, duke siguruar një nivel të përbashkët për ndërveprim të sigurt elektronik midis qytetarëve, bizneseve dhe autoriteteve publike, duke rritur efektivitetin, integritetin, sigurinë dhe besueshmërinë në ofrimin e shërbimeve të besuara në Republikën e Shqipërisë.
- Ndërtimi dhe funksionimi i Portofolit të Identitetit Digjital si mjet i qëndrueshëm dhe i besueshëm për menaxhimin e identitetit digjital.
- Plotësimi i kuadrit ligjor nëpërmjet përcaktimit të metodave të reja për një identifikim elektronik sa më të sigurt duke lehtësuar procesin e pajisjes me mjete të identifikimit elektronik dhe duke shkurtuar distancë si dhe shërbimeve të reja të besuara si arkivimin elektronik dhe vërtetimin elektronik të attributeve, menaxhimin e pajisjeve të krijimit të nënshkrimit elektronik, menaxhimin e pajisjeve të krijimit të vulës elektronike dhe regjistrat elektronikë.
- Rritja e ndërveprueshmërisë ndërkufitare të skemave të identifikimit elektronik dhe njohjes reciproke të tyre, duke lehtësuar përdorimin e tyre në kontekstin e integritit në tregun digjital evropian.
- Rritja e besueshmërisë së nënshkrimit/vulës elektronike përtej periudhës së vlefshmërisë teknologjike nëpërmjet rregullimit të shërbimit të kualifikuar të ruajtjes së nënshkrimeve/vulave elektronike të kualifikuara si dhe shërbimit të kualifikuar të vërtetimit të vlefshmërisë së nënshkrimeve/vulave elektronike të kualifikuara.
- Vendosja e rregullave për mbikëqyrjen e ofruesve të shërbimeve të besuara, certifikimin e skemave të identifikimit elektronik, portofolit të identitetit digjital, pajisjeve të krijimit të nënshkrimeve/vulave elektronike të kualifikuara.

OPSIONET E POLITIKAVE

Cilat janë opsionet kryesore të politikave? Duhet të bëni krahasimin e avantazheve/përfitimeve kryesore dhe të dizavantazheve/kostove të opsioneve të mundshme. (jo më shumë se 7 rreshta)

Opsionet e mëposhtme janë vlerësuar në funksion të arritjes së politikave:

Opsioni 0 – Ruajtja e status quo-së pa ndërhyrje në kuadrin ligjor ekzistues, Ligji nr.107/2015 “Për identifikimin elektronik dhe shërbimet e besuara”, i ndryshuar, dhe Ligji nr.9880/2008 “Për nënshkrimin elektronik”, i ndryshuar.

Opsioni 1 – Amendimi i kuadrit ligjor ekzistues për identifikimin elektronik dhe shërbimet e besuara.

Opsioni 2 – Miratimi i një ligji të ri.

Opsioni 3 - Investimi në zgjidhje teknologjike për përdorimin e identifikimit elektronik në distancë

Opsioni 0: Nënkupton mosndërmarrjen e asnjë politike duke vijuar me funksionimin sipas legjislacionit aktual. Ky opsion nuk ofron kosto shtesë por nga ana tjetër nuk ofron asnjë avantazh krahasuar me gjendjen ekzistuese në ofrimin e shërbimit të identifikimit elektronik, nënshkrimit elektronik, vulës elektronike, shërbimin elektronik të kualifikuar të regjistruar, autentifikimin e faqeve të internetit, si dhe në transaksionet elektronike

në Republikën Shqipërisë. Ky opsion nuk ka kosto financiare dhe nuk kërkon burime njerëzore, përveç fazës së monitorimit, por nga ana tjetër, nuk jep zgjidhje për problematikat e evidentuara.

Opsioni 1: Amendimi i kuadrit ligjor ekzistues për fushën e identifikimit elektronik dhe shërbimeve të besuara. Fusha e identifikimit elektronik dhe shërbimeve të besuara rregullohet aktualisht nga dy ligje, ligji nr.107/2015 “Për identifikimin elektronik dhe shërbimet e besuara”, i ndryshuar, dhe ligji nr.9880/2008 “Për nënshkrimin elektronik”, i ndryshuar, të cilët janë pjesërisht të përafuar me rregulloren e BE, nr. 910/2014, eIDAS. Në kuadër të teknikës legjislativë, duke qenë se ndryshimet që reflektohen në projektligj prekin më shumë se 50% të përmbajtjes së ligjit aktual, është e pamundur ndërmarrja e një nisme të tillë rregullatore, pasi do të krijonte konfuzion ligjor si dhe do të duhej amendimi i dispozitave të dy ligjeve të ndryshme. Gjithashtu, ky opsion ka kosto (kohe, burime njerëzore, financiare etj).

Opsioni 2: Hartimi i një ligji të ri, në përputhje të plotë me Rregulloren nr.910/2014 “Mbi identifikimin elektronik dhe shërbimet e besuara për transaksionet elektronike në tregun e brendshëm dhe shfuqizimin e Direktivës 1999/93/EC” dhe Rregulloren nr. 2024/1183 të Parlamentit Evropian dhe Këshillit të datës 11 Prill 2024, që ndryshon Rregulloren (BE) Nr. 910/2014 lidhur me krijimin e Identitetit Digjital Evropian dhe Rregulloren nr. 2024/1183 të Parlamentit Evropian dhe Këshillit të datës 11 Prill 2024, që ndryshon Rregulloren (BE) Nr. 910/2014 lidhur me krijimin e Identitetit Digjital Evropian. (eIDAS 1&eIDAS2)

Duke qenë se kuadri ligjor ekzistues që rregullon fushën e identifikimit elektronik dhe shërbimeve të besuara në Republikën e Shqipërisë është vetëm pjesërisht i përafuar me rregulloren eIDAS 910/2014 (e cila ka pësuar ndryshime duke filluar që nga data 30 prill 2024 me publikimin e saj në Fletoren Zyrtare të BE-së), shihet e arsyeshme hartimi i një ligji të ri, duke përfshirë të gjithë elementët që aktualisht mungojnë në legjislacionin ekzistues. Ky opsion do të garantonte bazën e duhur ligjore në fushën e identifikimit elektronik, ofrimin e shërbimeve të besuara si dhe përcaktime lidhur me portofolin e identitetit digjital, duke vendosur rregulla të qarta për të gjithë palët e përfshira. Gjithashtu hartimi i një ligji të ri ka kosto të konsiderueshme, krahasuar me opsionet e tjera të marra në konsideratë.

Opsioni 3 - Investimi në zgjidhje teknologjike për përdorimin e identifikimit elektronik në distancë Nënkupton mosndërmarrjen e asnjë ndërhyrje rregullatorë, por investimin në zgjidhje praktike teknologjike, të krijuara nga subjekte shqiptare për identifikimin elektronik në distancë për qytetarët dhe bizneset në Shqipëri. Ky opsion do të zgjidhte problemin e identifikuar nga sektori privat për mungesën e ofruesve të këtij shërbimi në vend, por nuk do t'i njihej efekti ligjor shërbimit. Dhe për rrjedhojë, do ishte një investim pa përfitime duke mos u dhënë zgjidhje gjithëpërfshirëse problematikave të identifikuara në zbatim.

ANALIZA E NDIKIMEVE

Cilat janë ndikimet e opsionit të preferuar? Kjo duhet të përshkruajë ndikimet në mënyrë sasiore (monetare) dhe cilësore (narrative) mbi buxhetin dhe grupet e tjera të prekura. (jo më shumë se 10 rreshta)

Ndikimet e drejtpërdrejta të opsionit të preferuar (Opsioni 2) :

- Përmirësimi dhe harmonizimi i kuadrit ligjor kombëtar në përputhje me *acquis communautaire* të BE-së duke futur elementët e rinj të cilët do të kompletojnë kornizën ligjore në fushën e identifikimit elektronik, shërbimeve të besuara dhe portofolin e identitetit digjital.

- Identifikimi elektronik në distanë (remote) i aplikuesit për pajisjen me mjete të identifikimit elektronik duke lehtësuar aksesin e qytetarëve dhe subjekteve përmes eliminimit të barrierave fizike dhe rritjes së efikasitetit në proceset administrative;
- Përcaktimi i rregullimeve të qarta ligjore lidhur me ushtrimin e veprimtarisë si dhe mbikëqyrjen e ofruesve të kualifikuar të shërbimit të besuar (procedura e regjistrimit, kërkesat që duhet të përmbushin, kërkesat e sigurisë që duhen ndërmarrë nga për menaxhimin e rreziqeve që prekin sigurinë dhe besueshmërinë e shërbimeve që ata ofrojnë etj).
- Rregullimi detyrimeve të ofruesve jo të kualifikuar të shërbimeve të besuara, përmes përcaktimeve ligjore që synojnë garantimin e transparencës dhe sigurisë minimale në ofrimin e këtyre shërbimeve në treg.

Lidhur me ndikimet monetare miratimi i këtij projektligji sjell efekte financiare për Buxhetin e Shtetit.

Efektet financiare negative për Buxhetin e shtetit për ata OKSHB që financohen nga Buxheti i Shtetit, në kuadër të investimeve që do të duhet të bëjnë me qëllim përmbushjen e masave të sigurisë, duke qenë se ligji përcakton rritjen e këtyre masave të cilat kërkojnë investime në teknologji dhe në rritjen e kapaciteteve si dhe përmbushjen e detyrimeve që ligji vendos (raporti i vlerësimit të konformitetit, certifikimi pajisjeve etj).

Gjithashtu krijimi dhe funksionimi i Portofolit të Identitetit Digjital (nëse do të bëhet nga një subjekt shtetëror) kërkon investime të konsiderueshme në infrastrukturë, teknologji dhe kapacitete njerëzore, çka përbën një ngarkesë financiare për buxhetin në fazat fillestare të zbatimit të ligjit.

Nga ana tjetër, projektligji parashikon mekanizma që gjenerojnë të ardhura për buxhetin e shtetit, të cilat burojnë nga tarifatat për regjistrimin e ofruesve të shërbimeve të besuara dhe organeve të vlerësimit të konformitetit. Këto të ardhura pritet të kompensojnë pjesërisht kostot e zbatimit dhe të krijojnë një ndikim financiar pozitiv në periudhë afatmesme dhe afatgjatë.

Analiza e ndikimit financiar është reflektuar në pjesën e dytë të RIA-së “Vlerësimi i opsioneve/analizimi i ndikimeve.”

ARSYETIMI I OPSIONIT TË PREFERUAR

Shpjegoni arsyet për zgjedhjen e opsionit të preferuar. Ju lutemi jepni nëse është e mundur koston dhe përfitimin me vlerë të përcaktuar monetare. (jo më shumë se 7 rreshta)

Opsioni i preferuar është zgjedhur **Opsioni 2**, pra miratimi i një ligji të ri “Për identifikimin elektronik, shërbimet e besuara dhe portofolin e identitetit digjital”, pasi :

- Transpozimi i Rregullores (BE) eIDAS 910/2014 dhe Rregullores nr. 2024/1183 (eIDAS2), do të kompletojë kornizën aktuale ligjore, duke përmbushur objektivin e përafrimit të legjislacionit vendas me atë të BE-së në kuadër të Planit Kombëtar të Integritimit Evropian të Republikës së Shqipërisë (2025-2027).
- Ofrimi i metodave të reja për identifikimin e aplikuesit për pajisjen me mjete të identifikimit elektronik.
- Ndërtimi dhe funksionimi i portofolit të identitetit digjital, një mekanizëm i cili do t’i japë çdo qytetari një mjet të sigurt, të kontrolluar dhe të centralizuar për përdorimin e identitetit të tij digjital në mënyrë të besueshme duke ruajtur privatësinë si dhe duke thjeshtuar ndjeshëm aksesin në shërbime publike e private.
- Rrit kërkesat e sigurisë dhe besueshmërinë në veprimtarinë e ofruesve të kualifikuar të shërbimeve të besuara.
- Rrit efektivitetin e shërbimeve të besuara të përdorura për të hyrë në shërbimet online publike apo private dhe të transaksioneve elektronike në Republikën e Shqipërisë.

- Ka impakt financiar në buxhetin e shtetit duke i sjellë atij të ardhura të cilat burojnë nga tarifat e regjistrimit të ofruesve të shërbimit të besuar/organeve të vlerësimit të konformitetit.

Lidhur me analizën financiare për koston e opsionit të preferuar mbi buxhetin e shtetit varet nga vlera e tarifave që do përcaktohen me Vendim të Këshillit të Ministrave si dhe subjekteve që do të regjistrohen sipas përcaktimeve të këtij ligji. Analiza është bërë në pjesën e dytë të RIA-së “Vlerësimi i opsioneve/analizimi i ndikimeve.”

KONSULTIMI

Jepni një përmbledhje të çdo konsultimi të kryer (me kë dhe si jeni konsultuar? (jo më shumë se 5 rreshta)

Projektligji është hartuar nga Autoritetit Kombëtar për Sigurinë Kibernetike. Projektligji, në zbatim të ligjit 146/2014, i është nënshtruar procesit të konsultimit publik nëpërmjet publikimit të tij në portalin “Regjistri elektronik për Njoftimet dhe Konsultimet Publike”, nga data 03.06.2025 deri në datën 30.06.2025.

Gjatë kësaj periudhe projektligji u publikua edhe në faqen zyrtare të Autoritetit për konsultim.

Gjithashtu, më datat 26 dhe 27 qershor, Autoriteti organizoi në ambientet e tij takime konsultative me grupet e interesit të prekura nga ky projektligj. Pjesëmarrësit në këto takime u njoftuan paraprakisht nga Autoriteti përmes shkresave zyrtare dhe postës elektronike. Gjatë këtyre takimeve u prezantuan risitë kryesore të projektligjit dhe u ftuan përfaqësuesit e grupeve të interesit të shprehnin komentet dhe sugjerimet e tyre.

Në këto takime kishte përfaqësues të AKSHI -t, Identitek sha, përfaqësues nga subjekte të sektorit bankar, mikrofinanciar dhe fintech, si dhe përfaqësues nga institucionet publike, që ofrojnë shërbime publike elektronike. Numri total i pjesëmarrësve në këto takime ishte 46 persona.

Nga takimet konsultative të zhvilluara, pjesëmarrësit ngritën diskutime kryesisht në lidhje me Portofolin e Identitetit Digjital, shërbimet e besuara si arkivimi elektronik, afatin e miratimit të këtij projektligji etj. Për të gjitha çështjet e ngritura, Autoriteti ofroi sqarimet e nevojshme. Megjithatë, nga grupet e interesit nuk është përcjellë asnjë koment me shkrim apo përmes emailit lidhur me projektligjin.

Nga publikimi në Regjistrin Elektronik për Njoftimet dhe Konsultimet Publike, kanë dërguar komente dy subjekte. Me email-in e datës 01.07.2025 u dërguan komente lidhur me projektligjin nga shoqëria One Albania dhe me shkresën nr. 34 prot, datë 04.07.2025, protokolluar nga ne me nr.2107 prot, datë 09.07.2025 ka dërguar komente Dhoma Amerikane e Tregëtisë. Komente e dërguara ishin kryesisht të natyrës Standarded/termat e references, afati i akteve nënligjore të përcaktuara në projektligj, portofoli i identitetit digjital, zbatueshmëria direkte e Rregullores eIDAS, përfshirja e operatorëve të huaj të certifikuar në BE etj.

Sugjerimet e dërguara janë shqyrtuar nga Autoriteti, dhe janë reflektuar në raportin individual të konsultimit publik.

ZBATIMI DHE MONITORIMI

Si do të organizohen zbatimi dhe monitorimi?(jo më shumë se 5 rreshta)

Institucionet përgjegjëse për monitorimin e opsionit të preferuar janë:

- Autoriteti Kombëtar për Sigurinë Kibernetike është institucioni përgjegjës për rregullimin dhe mbikëqyrjen e fushës së identifikimit elektronik dhe shërbimeve të besuara në Republikën e Shqipërisë. Autoriteti do të hartojë aktet përkatëse nënligjore dhe do të mbikëqyrë subjektet në përputhje me kërkesat e këtij ligji. Mbikëqyrja do të resalizohet nëpërmjet rezultateve nga raportimet periodike të OKSHB-ve tek Autoriteti, kontrolleve për vlerësimin e konformitetit të veprimtarisë së tyre sipas përcaktimeve të bëra në këtë ligj.
- Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë dhe AKSHI si institucione që drejtojnë GPNIE të kapitullit 10 “Shoqëria e informacionit dhe media” që koordinon procesin me institucionet përkatëse gjatë raportimeve periodike

- Subjektet përgjegjëse për zbatim janë: Ofruesit e Kualifikuar të Shërbimit të Besuar të akredituar në Republikën e Shqipërisë, ofruesit jo të kualifikuar të shërbimeve të besuara, organet publike, Organet e vlerësimit të konformitetit , institucioni përgjigjegjës për ofrimin e portofolit të identitetit digjital i cili duhet të marrë të gjitha masat përkatëse për të qënë konform kërkesave të ligjit (përmbushja e kërkesave konform këtij ligji, për të funksionuar si i tillë, përmbushja e detyrimeve përkatëse në ushtrimin e veprimtarisë së tyre etj.)

Politika do të monitorohet në mënyrë të vazhdueshme nga Autoritetit përmes analizave 6 dhe 12 mujore të tyre.

Tregues të suksesit të politikës janë:

- Numri i OKSHB-ve , OVK-ve, të regjistruara në Republikën e Shqipërisë.
- Numri i ofruesve të pakualifikuar të shërbimeve të besuara që ushtrojnë aktivitetin e tyre në Republikën e Shqipërisë.
- Ndërtimi, certifikimi dhe funksionimi efektiv i portofolit të identitetit digjital.
- Raportimet periodike të bëra nga OKSHB pranë Autoritetit, në përputhje me detyrimet ligjore.
- Vlerësimet nga kontrollet lidhur me konformitetin e veprimtarisë së OKSHB-ve.
- Numri i shërbimeve publike dhe private në të cilat përdoret nënshkrimi elektronik, vula elektronike, dhe identifikimi elektronik.
- Numri i qytetarëve, subjekteve dhe institucioneve që janë pajisur me certifikata të kualifikuara për nënshkrim elektronik vula elektronike, identifikim elektronik.

PJESA 2: BAZA KRYESORE E ANALIZËS DHE E PROVAVE

Historik

Jepni kontekstin e politikës.

Direktiva Evropiane 1999/93 / EC e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit mbi një kuadër të përbashkët për nënshkrimet elektronike, ishte direktiva e parë që u miratua për përcaktimin e kuadrit ligjor të përbashkët për Shtetet Anëtare të BE -së si bazë për legjislacionin në fushën e nënshkrimit elektronik.

Bazuar në Direktivën e KE 1999/93 / EC, në Shqipëri u miratua ligji nr. 9880 i datës 25.2.2008 "Për Nënshkrimin Elektronik" i cili hapi rrugën për transaksione të sigurta elektronike në vend.

Në qershor 2014, u miratua Rregullorja e re Evropiane nr. 910/2014 "Për Identifikimin Elektronik dhe Shërbimet e Besuar për Transaksionet Elektronike në Tregun e Brendshëm", e cila zëvendësoi Direktivën Evropiane 1999/93 / EC.

Shqipëria në 2015 miratoi ligjin nr. 107/2015, "Për identifikimin elektronik dhe shërbimet e besuara", dhe me pas u miratuan aktet nënligjore.

Të dy këto ligje, Ligji Nr. 9880/2008 "Për Nënshkrimin Elektronik", si dhe ligji nr. 107/2015 "Për identifikimin elektronik dhe shërbimet e besuara" pësuan ndryshime në vitin 2016. Këto dy ligje si dhe aktet nënligjore të

nxjerra në zbatim të tyre kanë transpozuar pjesërisht Rregulloren Evropiane nr. 910/2014 “Mbi identifikimin elektronik dhe shërbimet e besuara për transaksionet elektronike në tregun e brendshëm”.

Ligji nr. 9880, datë 25.02.2008, “Për Nënshkrimin Elektronik”, përcakton kuadrin ligjor për krijimin, përdorimin dhe njohjen e nënshkrimit elektronik në Republikën e Shqipërisë. Ky ligj rregullon nënshkrimet elektronike të kualifikuara, përcakton kërkesat teknike për vlefshmërinë e tyre dhe efektet juridike që ato prodhojnë, duke u njohur me fuqi të barabartë ligjore me nënshkrimin me dorë. Gjithashtu, ligji vendos rregulla për veprimtarinë e ofruesve të shërbimeve të certifikimit, përfshirë procedurat e lëshimit dhe administrimit të certifikatave elektronike, si dhe mekanizmat e mbikëqyrjes dhe të sigurisë, me qëllim garantimin e besueshmërisë, integritetit dhe përdorimit të sigurt të nënshkrimeve elektronike.

Ndryshuar

Ligji nr. 9880/2008, datë 25.2.2008, “Për Nënshkrimin Elektronik është ndryshuar me aktin normativ nr. 8, datë 30.9.20091, ligjin nr. 122/2016, 15.12.2016 dhe aktin normativ nr.18, datë 9.12.20222. (Ndryshimet e pësuara lidhen me përmbajtjen e ligjit konkretisht është ndryshuar pika 15 e nenit 3 “Përkufizime”, dhe neni 10 “ Autoriteti Përgjegjës për Certifikimin Elektronik dhe Sigurinë Kibernetike”, është shtuar neni 10/1 “Emërimi, lirimi ose shkarkimi i drejtorit të Përgjithshëm” neni 22 “Transferimi i detyrave të shërbimeve të certifikimit”, neni 54 “Pranimi dhe përdorimi i nënshkrimeve elektronike dhe i produkteve të huaja” neni 58 “Ankimi dhe ekzekutimi”, neni 59 “Aktet nënligjore” si dhe “Dispozita Kalimtare”. Ndryshimet konsistojnë në rishikimin e emërimit të autoritetit përgjegjës, shtimin e dispozitave që rregullojnë funksionet dhe kompetencat e Drejtorit të Përgjithshëm, si dhe parashikimin e mundësisë për njohjen e identifikimit dhe e shërbimeve të besuara të lëshuara nga një OKSHB në BE.

Ligji nr. 107/2015, datë 01.01.2015, “Për Identifikimin Elektronik dhe Shërbimet e Besuara”, përcakton kuadrin ligjor për identifikimin elektronik të personave dhe ofrimin e shërbimeve të besuara në Republikën e Shqipërisë. Ky ligj rregullon mënyrat e identifikimit elektronik, nivelet e sigurisë, përdorimin e mjeteve të identifikimit dhe ofrimin e shërbimeve të besuara, përfshirë, vulën elektronike, shërbimet e transmetimit elektronik etj. Ligji përcakton gjithashtu kushtet dhe kriteret që duhet të përmbushin ofruesit e shërbimeve të besuara për të marr statusin “i kualifikuar”, si dhe procedurat e mbikëqyrjes dhe mekanizmat për garantimin e sigurisë, me qëllim rritjen e besueshmërisë së transaksioneve elektronike dhe njohjen ligjore të tyre.

Ndryshuar

Ligji nr. 107/2015, datë 1.1.2015, “Për Identifikimin Elektronik dhe Shërbimet e Besuara” është ndryshuar me ligjin nr. 123/2016, datë 15.12.2016. (Ndryshimet e pësuara lidhen me përmbajtjen e ligjit konkretisht në fund pikës 1 të nenit 7 “Kushtet për identifikimin fillestar” është hequr “elektronik”, tek neni 27 “Kërkesat për shërbime elektronike të kualifikuara për transmetimin elektronik” është shtuar një akt nënligjor si dhe është shtuar pika 3 e nenit 34 “Pranimi dhe përdorimi i produkteve të huaja” . Ndryshimet konsistojnë në shtimin e një akti nënligjor si dhe mundësisë për njohjen e identifikimit dhe shërbimet e besuara të lëshuara nga një OKSHB në BE.

Aktet nënligjore në :

- VKM Nr. 503, datë 13.5.2009, “Për tarifat e shërbimeve që ofrohen nga AKCE” (I përditësuar)
- VKM nr. 69, datë 27.1.2016, “Për miratimin e rregullores “Për Identifikimin Elektronik dhe Shërbimet e Besuara”.
- VKM Nr. 495, datë 13.9.2017, “Për miratimin e rregullave të përfitimit të shërbimeve publike elektronike“.
- Udhëzimi Nr.1, datë 15.03.2023 “Mbi përfundimin e aktivitetit të Ofruesit të Kualifikuar të Shërbimit të Besuar dhe Transferimin e Shërbimit” i ndryshuar.
- Udhëzim Nr.1: Për dokumentacion e regjistrimit të ofruesit të kualifikuar të shërbimit të besuar.
- Udhëzim Nr.2: Për dokumentacionin e regjistrimit të organizmit të testimit dhe konfirmimit.
- Udhëzim Nr.3: Për afatet e përgjithshme.
- Udhëzim Nr 4: Mbi procedurat e identifikimit dhe vulave elektronike (I përditësuar)

Neni 70 i Marrëveshjes së Stabilizim Asocimit (MSA) përcakton angazhimin e Shqipërisë për përafrimin e legjislacionit ekzistues me *acquis* e BE-së. Plani Kombëtar për Integrimin Evropian ka për qëllim të koordinoj këtë proces përafrimi duke synuar njëkohësisht plotësimin e detyrimeve në kuadër të MSA dhe detyrimet që lindin në kuadër të procesit të anëtarësimit në Bashkimin Evropian.

Autoriteti Kombëtar për Sigurinë Kibernetike, si institucioni përgjegjës në fushën e identifikimit elektronik dhe shërbimeve të besuara, në kuadër të Planit Kombëtar për Integrimin Evropian 2024-2026 (PKIE 2024-2026), kishte marrë përsipër detyrimin për përafrimin e plotë të kuadrit ligjor për identifikimin elektronik dhe shërbimet e besuara me Rregulloren nr.910/2014 të BE-së, eIDAS.

Komisioni Evropian në datën 30 prill, 2024, publikoi në Fletoren Zyrtare të BE-së, Rregulloren nr. 2024/1183 të Parlamentit Evropian dhe Këshillit të datës 11 prill 2024, e cila ndryshon Rregulloren (BE) Nr. 910/2014 në lidhje me krijimin e Kornizës Evropiane të Identitetit Digjital (eIDAS 2), rregullore e cila tashmë është në fuqi.

Duke qenë se risitë që kjo rregullore sjell janë shumë komplekse dhe teknike të cilat kërkojnë më shumë kohë për ti përfshirë në legjislacionin tonë kombëtar miratimi i këtij ligji kaloi si planifikim në PKIE 2025-2027 ku është parashikuar transpozimi i plotë i Rregullosës (BE) Nr.910/2014 e Parlamentit Evropian dhe të Këshillit të datës 23 korrik 2014 “Mbi identifikimin elektronik dhe shërbimet e besuara për transaksionet elektronike në tregun e brendshëm, dhe shfuqizimin e Direktivës 1999/93/KE” dhe Rregullosës 2024/ 1183 të BE-së.

Problemi në shqyrtim

1. *Përshkruani natyrën e problemit.*
2. *Identifikoni shkaqet e problemit.*
3. *Përshkruani shtrirjen e problemit.*
4. *Identifikoni grupet e prekura nga ky problem - qeveria / biznesi / shoqëria civile / qytetarët.*
5. *Vlerësoni nëse problemi mund të trajtohet ose jo përmes një ndryshimi të politikave.*

Kuadri ligjor aktual që rregullon identifikimin elektronik dhe shërbimet e besuara në Republikën e Shqipërisë është i fragmentuar (në dy ligje, përkatësisht ligji nr.9880/2008 “Për nënshkrimin elektronik, i ndryshuar, ligji nr.107/2015 “Për identifikimin elektronik dhe shërbimet e besuara”, i ndryshuar) dhe jo i harmonizuar plotësisht me *acquis* të Bashkimit Evropian, në fushën e identifikimit elektronik dhe shërbimeve të besuara. Mungesa e dispozitave të qarta për identifikimin elektronik në distancë, portofolin e identitetit digjital, njohjen reciproke të skemave të identifikimit elektronik, si dhe rregullimi i papërshtatshëm i pajisjeve dhe shërbimeve të besuara e kufizon zhvillimin e mëtejshëm të administratës digjitale, ekonomisë digjitale dhe sigurisë juridike në transaksionet elektronike.

Disa nga problematikat dhe mangësitë e evidentuara janë si më poshtë vijon:

- Mungesa e rregullimit të identifikimit elektronik në distancë (*remote*) apo të metodave të tjera ekuivalente me prezencën fizike për një identifikim elektronik sa më të sigurt, ku si rrjedhojë nuk ofrohet identifikimin elektronik në distancë për qytetarët dhe bizneset.
- Mungesa e dispozitave ligjore të portofolit të identitetit digjital si mjet gjithëpërfshirës për ruajtjen dhe përdorimin e sigurt të attributeve identifikuese të individit sjell si pasojë mosekzistencën e një mjeti identifikimi elektronik të sigurt dhe ndërveprues siç është portofoli, me qëllim akesin në shërbime publike dhe private për qytetarët dhe bizneset.

- Mungesa e mekanizmave të njohjes reciproke si dhe ndërveprimin e skemave të identifikimit elektronik/portofolit të identitetit digjital në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar dhe si rrjedhojë, nuk ka një njohje reciproke dhe ndërveprim me sistemet e identifikimit elektronik në BE, çka pengon transaksionet ndërkufitare.
- Mungesa e rregullimit të pasojave në rast të shkeljes së sigurisë apo humbjes së integritetit që kanë një impakt të rëndësishëm tek të dhënat personale apo në shërbimet e besuara të ofruara nga ofruesit e kualifikuar të shërbimeve të besuara.
- Mungesa e rregullimit të certifikimit të pajisjeve të krijimit të nënshkrimeve elektronike të kualifikuara dhe vulave elektronike të kualifikuara, dhe si pasojë nuk ka rregullime të qarta për sigurinë, integritetin dhe certifikimin e pajisjeve dhe shërbimeve të besuara.
- Mungesa e parashikimeve në legjislacionin aktual lidhur me rregullimin e shërbimit të kualifikuar të ruajtjes së nënshkrimeve/vulave elektronike të kualifikuara si dhe shërbimin e kualifikuar të vërtetimit të vlefshmërisë së nënshkrimeve/vulave elektronike të kualifikuara me qëllim për të rritur besueshmërinë e nënshkrimit elektronik të kualifikuar përtej periudhës së vlefshmërisë teknologjike.

Këto problematika kufizojnë zhvillimin e administratës digjitale, ekonomisë digjitale dhe sigurinë juridike të transaksioneve elektronike për qytetarët, bizneset dhe institucionet publike, pasi Shqipëria ka një kuadër ligjor të fragmentuar dhe jo në përputhje të plotë me BE-në, që pengon përdorimin e sigurt dhe efektiv të identifikimit elektronik dhe shërbimeve të besuara.

Shtrirja e problemit lidhet me të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë, pasi mungesa e harmonizimit ligjor dhe infrastruktura e paplotë për identifikimin elektronik dhe shërbimet e besuara prekin përdorimin e nënshkrimit elektronik dhe aksesin në shërbime online në të gjithë vendin. Problemi është i shtrirë horizontalisht dhe vertikalisht në të gjitha nivelet e qeverisjes dhe ndërveprimit digjital, si në sektorin publik, ashtu edhe në atë privat. Ai prek përdorimin e nënshkrimit elektronik në dokumentacionin zyrtar, aksesin e qytetarëve dhe bizneseve në shërbimet publike dhe private online, garantimin e sigurisë dhe integritetit të transaksioneve digjitale, si dhe aftësinë e vendit për të zhvilluar mekanizma të bashkëpunimit ndërkufitar të njohur nga BE.

Për sa i përket grupeve të prekura nga ky problem janë kryesisht të gjithë ofruesit e kualifikuar të shërbimit të besuar, ofruesit e pakualifikuar të shërbimit të besuar dhe përdoruesit e këtyre shërbimeve përfshirë bizneset, administratën publike dhe qytetarët. Për ofruesit e kualifikuar të shërbimit të besuar dhe ofruesit e pakualifikuar të shërbimit të besuar, problematikat sipërcituara sjellin pamundësinë për të ofruar shërbime të besuara të reja dhe sipas standardeve evropiane sipas përcaktimeve në rregulloret eIDAS1 dhe eIDAS2. Për sa i përket bizneseve dhe qytetarëve, problematikat e sipërcituara pengojnë në mënyrë të drejtpërdjetë marrjen e shërbimeve të identifikimit elektronik dhe shërbimeve të besuara sipas standardeve evropiane, si dhe sjellin mosnjohjen e efekteve ligjore në transaksione elektronike brenda vendit dhe ndërkufitare, gjë që kufizon kapacitetin e tyre për të përfituar maksimalisht nga këto shërbime në treg.

Arsyeja e ndërhyrjes

6. *Shpjegoni pse qeveria e sheh të nevojshme të ndërhyjë.*
7. *Shpjegoni se çfarë shpreson të trajtojë qeveria nëpërmjet kësaj ndërhyrjeje.*
8. *Shpjegoni se si i mbështet kjo ndërhyrje objektivat e nivelit të lartë të qeverisë.*
9. *Rendisni punën ekzistuese që është realizuar tashmë.*

Nevoja për ndërhyrje

Ndërhyrja e qeverisë është e nevojshme për të adresuar boshllëqet dhe problematikat e evidentuara gjatë zbatimit të legjislacionit aktual në fushën e identifikimit elektronik dhe shërbimeve të besuara. Këto problematika lidhen kryesisht me mungesën e rregullimit të identifikimit elektronik në distancë, mungesën e një portofoli të identitetit digjital, mungesën e standardeve për certifikimin dhe sigurinë e pajisjeve të krijimit të nënshkrimeve/vulave elektronike, si dhe me mungesën e dispozitave për njohjen reciproke dhe ndërveprimin e skemave të identifikimit elektronik.

Zhvillimet e shpejta teknologjike dhe rritja e nevojës për përdorimin e shërbimeve publike dhe private online kërkojnë një ndërhyrje të menjëhershme për të modernizuar kuadrin ligjor dhe për të mundësuar ofrimin e shërbimeve të sigurta, të aksesueshme dhe të besueshme. Identifikimi elektronik në distancë sjell përfitime të konsiderueshme në lehtësimin e procedurave administrative, uljen e kostove dhe reduktimin e kohës, por në të njëjtën kohë kërkon garantimin e një niveli të lartë sigurie, ekuivalent me atë të identifikimit me prezencë fizike. Për këtë arsye, është e domosdoshme forcimi i standardeve të sigurisë që duhet të përmbushen nga ofruesit e shërbimeve të besuara.

Ndërhyrja parashikon gjithashtu rregullimin e shërbimit të kualifikuar të ruajtjes së nënshkrimeve/vulave elektronike të kualifikuara, si dhe të shërbimit të vërtetimit të vlefshmërisë së tyre, me qëllim rritjen e besueshmërisë dhe qëndrueshmërisë së tyre përtej periudhës së vlefshmërisë teknologjike.

Gjithashtu, bazuar në Vendimin nr. 621, datë 10.10.2024 Për miratimin e dokumentit të politikës “Agjenda Kombëtare e Reformave 2024–2027”, në kuadër të instrumentit të Bashkimit Evropian “Faciliteti për Reforma dhe Rritje për Ballkanin Perëndimor”, në zbatim të Reformës R-3.1.1 Përputhshmëria me Rregulloren e Identitetit Digjital dhe zbatimi i *e-Portofolit Digjital* për shërbimet publik, kjo ndërhyrje vjen dhe si një detyrim i shtetit shqiptar për harmonizimin e legjislacionit shqiptar me rregulloren eIDAS2. Po ashtu, bazuar në Agjendën Kombëtare të Reformave të sipërcituar, Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit (AKSHI) ka angazhimin të zbatojë portofolin e identitetit digjital sipas Reformës R-3.1.1, hapi 4 – Zbatimi i një Portofoli Digjital për shërbimet elektronike publike, në përputhje me standardet e Bashkimit Evropian, duke e pilotuar si pjesë të Portofolit të Identitetit Digjital të e shërbimeve publike, për të paktën 10 e-shërbime publike deri në dhjetor 2026. Po ashtu në hapat 2 dhe 5 të kësaj reforme, janë parashikuar arritja e njohjes reciproke të shërbimeve të besuara me Komisionin Evropian përmes përfshirjes së Shqipërisë në Listën e Besuar të Vendeve të Treta të BE-së si dhe arritja e marrëveshjeve të njohjes reciproke me partnerët e Ballkanit Perëndimor në lidhje me shërbimet e besuara.

Në këtë kontekst, me qëllim zbatimin e të gjithë hapave të reformës R 3.1.1 të Agjendës Kombëtare të Reformave, dhe specifikisht ngritjen e portofolit të identitetit digjital në Republikën e Shqipërisë, kjo ndërhyrje është e domosdoshme për të mundësuar kuadrin e nevojshëm ligjor.

Për më tepër, Plani Kombëtar për Integrimin Evropian 2024-2026 ka parashikuar procesin e përafrimit të legjislacionit kombëtar me acquis të Bashkimit Evropian në fushën e identifikimit elektronik dhe shërbimet e besuara dhe për rrjedhojë nisma konsiderohet e nevojshme për përshpejtimin e procesit të integritimit evropian.

Çfarë shpreson të trajtojë qeveria nëpërmjet kësaj ndërhyrjeje

Përmes kësaj nisme legjislative, qeveria synon të:

- Mundësojë identifikimin elektronik në distancë në mënyrë të sigurt dhe të certifikuar;
- Përcaktojë rregulla të detajuara për funksionimin, certifikimin dhe mbikëqyrjen e pajisjeve të krijimit të nënshkrimeve dhe vulave elektronike të kualifikuara;

- Rregullojë shërbimin e kualifikuar të ruajtjes së nënshkrimeve dhe vulave elektronike të kualifikuara, duke rritur besueshmërinë e tyre përtej afatit të vlefshmërisë teknologjike;
- Përcaktojë dispozita për shërbimin e kualifikuar të vërtetimit të vlefshmërisë së nënshkrimeve/vulave elektronike, duke garantuar një proces të sigurt dhe të saktë për palët e përfshira;

Si i mbështet kjo ndërhyrje objektivat e nivelit të lartë të qeverisë

Hartimi i një ligji të ri për identifikimin elektronik, shërbimet e besuara dhe portofolin e identitetit digjital mbështet drejtpërdrejt objektivat strategjike të Qeverisë së Republikës së Shqipërisë në disa drejtime të rëndësishme:

- Nisma ligjore është në përputhje me angazhimet e Shqipërisë në kuadër të Planit Kombëtar për Integrimin Evropian 2025–2027 dhe synon përafrimin me Rregulloren 910/2014 dhe Rregulloren 2024/1183(BE) për identitetin digjital evropian. Kjo do të mundësojë njohjen reciproke dhe ndërveprimin ndërkufitar të skemave dhe portofolëve të identitetit digjital, duke lehtësuar aksesin e qytetarëve dhe bizneseve shqiptare në tregun e përbashkët digjital evropian.
- Ligji i ri krijon bazën për rritjen e cilësisë dhe sigurisë së shërbimeve publike nëpërmjet identifikimit elektronik të besueshëm dhe shërbimeve të besuara, duke mundësuar ofrimin e tyre në mënyrë të sigurt dhe të aksesueshme për qytetarët dhe subjektet private.
- Rritja e besimit në transaksionet elektronike – Rregullimi i shërbimeve të ruajtjes, certifikimit dhe vërtetimit të nënshkrimeve dhe vulave elektronike të kualifikuara kontribuon në rritjen e sigurisë juridike dhe teknologjike, duke nxitur përdorimin e mjeteve të identifikimit, nënshkrimit elektronik.
- Ligji synon të krijojë një mjedis të sigurt dhe të parashikueshëm për ofruesit e shërbimeve të besuara dhe përdoruesit e tyre, përfshirë bizneset, duke ndihmuar në reduktimin e kostove, thjeshtimin e procedurave dhe promovimin e inovacionit.

Puna ekzistuese që është realizuar tashmë

Në zbatim të ligjit nr. 9880/2008 “Për nënshkrimin elektronik” dhe ligjit nr. 107/2015 “Për identifikimin elektronik dhe shërbimet e besuara”, Autoriteti Kombëtar për Sigurinë Kibernetike ka dhënë statusin “Ofrues i Kualifikuar i Shërbimeve të Besuara - OKSHB” dy subjekteve, përkatësisht ALEAT Sh.p.k dhe Agjencisë Kombëtare për Shoqërinë e Informacionit. Aktualisht, në Republikën e Shqipërisë opeon vetëm një OKSHB, AKSHI, pasi ALEAT Sh.p.k ka ndërprerë veprimtarinë në vitin 2023. AKSHI ofron shërbimet e besuara të kualifikuara si nënshkrim elektronik i kualifikuar, vulë elektronike e kualifikuar dhe vulë kohore elektronike e kualifikuar.

Autoriteti Kombëtar për Sigurinë Kibernetike ka ushtruar kompetencat mbikëqyrëse në përputhje me legjislacionin në fuqi ku OKSHB-të dorëzojnë raportin vjetor mbi veprimtarinë e tyre. Gjithashtu, Autoriteti ka shqyrtuar çdo kërkesë të paraqitur nga subjektet për të marrë statusin “Ofrues i Kualifikuar i Shërbimeve të Besuara” duke vlerësuar dokumentacionin e paraqitur për plotësimin e kërkesave ligjore dhe teknike sipas legjislacionit në fuqi.

Gjatë kësaj periudhe, Autoriteti ka identifikuar problematikat e paraqitura nga subjektet duke konstatuar mangësi në legjislacionin ekzistues.

Objektivi i politikës

1. *Vendosni objektiva që korrespondojnë me problemin dhe shkaqet e tij.*
2. *Sigurohuni që objektivat e vendosur të korrespondojnë me ato të dhëna në përmbledhjen ekzekutive, por më të detajuara.*

3. *Sigurohuni që objektivat janë specifike, të matshëm, të arritshëm, realë dhe në kohë.*

Nëpërmjet kësaj nisme, synohet përmbushja e objektivave të mëposhtme:

- Rritja në një përqindje (%) të konsiderueshme e përdorimit të identifikimit elektronik dhe shërbimeve të besuara në transaksionet elektronike në vend, duke siguruar një nivel të përbashkët për ndërveprim të sigurt elektronik midis qytetarëve, bizneseve dhe autoriteteve publike, duke rritur efektivitetin, integritetin, sigurinë dhe besueshmërinë në ofrimin e shërbimeve digjitale në Republikën e Shqipërisë deri në vitin 2027.
- Ofrimi i metodave të reja të identifikimit elektronik në shërbimet digjitale duke lehtësuar procesin e aksesit në shërbime publike dhe private përmes shkurtimeve të kohës, heqjes së barrierave administrative dhe përdorimit të aplikacioneve të reja teknologjike, deri në vitin 2027.
- Ndërtimi dhe funksionimi i të paktën një Portofoli të Identitetit Digjital në Republikën e Shqipërisë si mjet i qëndrueshëm dhe i besueshëm për identitetin digjital deri në fund të vitit 2026;
- Rritja e numrit të personave që do të kenë aksesueshmëri, në mjetet e identifikimit elektronik, përfshirë Portofolin e Identitetit Digjital, përfshirë personat me aftësi të kufizuara, deri në fund të vitit 2026.
- Rritja e numrit të ofruesve të shërbimeve të identifikimit elektronik deri në fund të vitit 2027 me qëllim zbatimin e metodave të reja të identifikimit elektronik, zhvillimin e tregut vendas dhe ofrimin e shërbimeve me kosto efikente.
- Rritja e numrit të ofruesve të shërbimeve të besuara, jo të kualifikuar dhe të kualifikuar, deri në fund të vitit 2027 me qëllim zgjerimin e ofrimit të shërbimeve të besuara në vend, zhvillimin e tregut vendas dhe ofrimin e shërbimeve me kosto efikente.

Përshkrimi i opsioneve të shqyrtuara

1. *Përshkruani opsionin e status quo-së.*
2. *Identifikoni dhe përshkruani të gjitha opsionet e politikave që keni marrë parasysh.*
3. *Shpjegoni se si janë identifikuar opsionet e politikës.*

Opsionet e mëposhtme janë vlerësuar në funksion të arritjes së politikave:

Opsioni 0 – Ruajtja e status quo-së pa ndërhyrje në kuadrin ligjor ekzistues për fushën e identifikimit elektronik dhe shërbimeve të besuara.

Opsioni 1 – Amendimi i kuadrit ligjor për identifikimin elektronik dhe shërbimet e besuara.

Opsioni 2 – Miratimi i një ligji të ri.

Opsioni 3 - Investimi në zgjidhje teknologjike për përdorimin e identifikimit elektronik në distancë

Opsioni 0 (ruajtja e status quo-së): Ky opsion konsiston në mospërfshirjen e asnjë ndërhyrjeje të re legjislative, duke vijuar me zbatimin e kuadrit ekzistues ligjor, përkatësisht ligjit nr. 107/2015 “Për identifikimin elektronik dhe shërbimet e besuara” (i ndryshuar), si dhe ligjit nr. 9880/2008 “Për nënshkrimin elektronik” (i ndryshuar). Ky opsion do të thotë, mosbërjen e ndryshime, vijimi me të njëjtat politikat duke pritur që situata të vetërregullohet. Ky opsion nuk ofron asnjë avantazh krahasuar me gjendjen ekzistuese në fushën e identifikimit elektronik dhe të shërbimeve të besuara, duke mosofruar asnjë zgjidhje për problematikat e evidentuara. Ky opsion nuk ka kosto financiare dhe nuk kërkon burime njerëzore, përveç fazës së monitorimit, por nga ana tjetër, nuk jep zgjidhje për problematikat e evidentuara.

Vlerësimi i opsionit:

- **Avantazhe:** Nuk krijon kosto shtesë financiare ose burime shtesë njerëzore, kërkon vetëm mbajtjen në fuqi dhe monitorimin e dispozitave ekzistuese.
- **Disavantazhe:** Ky opsion nuk ofron zgjidhje për problematikat e evidentuara si mungesa e ndërveprueshmërisë ndërkufitare, mungesa e portofolit të identitetit digjital, standardeve të përbashkëta të sigurisë, si dhe e bazës për mbikëqyrjen efektive të ofruesve të shërbimeve të besuara. Ruajtja e status quo-së pengon gjithashtu edhe përpjekjet për përafrim me *acquis communautaire* të BE-së.

Opsioni 1: Amendimi i ligjit aktual nr.107/2015 “Për Identifikimin Elektronik dhe Shërbimet e Besuara” (i ndryshuar) dhe ligjit nr.9880/2008 “Për nënshkrimin elektronik”(i ndryshuar). Ky opsion mundëson ruajtjen e një strukturë të njohur për aktorët institucionalë dhe për tregun dhe teorikisht mund të konsiderohet si alternativë me kosto më të ulët në afat të shkurtër. Edhe pse opsioni ruan strukturën ekzistuese, ai nuk garanton harmonizimin e plotë me standardet e BE-së, për shembull për njohjen reciproke të identifikimeve elektronike dhe portofolit digjital. Edhe pse kostoja e menjëhershme mund të jetë më e ulët, në plan afatmesëm dhe afatgjatë, rinevojitet rishikimi i përhershëm për të adresuar boshllëqet që nuk mund të harmonizohen brenda ligjeve ekzistuese, gjë që mund të rezultojë në shpenzime të përsëritura.

Megjithatë, në kuadër të teknikës legislative, duke qenë se ndryshimet që reflektohen në projektligj prekin më shumë se 50% të përmbajtjes së ligjit aktual, është e pamundur ndërmarrja e një nisme të tillë rregullatore, pasi do të krijonte konfuzion ligjor dhe do të humbiste kuptueshmëria e ligjit, duke qenë se ky ligj është amenduar dhe më parë. Gjithashtu, do të duhej amendimi i dispozitave të dy ligjeve të ndryshme, i cili paraqet kosto të shtuar në kohë dhe në burime njerëzore .

Opsioni 2: Hartimi i një ligji të ri, në përputhje të plotë me Rregulloren e IDAS (1 dhe 2).

Synimi është përfshirja e elementeve që aktualisht mungojnë në legjislacionin ekzistues, duke ecur në linjën e BE-së me qëllim përafrimin e plotë me Rregulloren eIDAS për të plotësuar mangësitë në legjislacionin aktual, si dhe për të rritur kërkesat për sigurinë në ushtrimin e veprimtarisë të ofruesve të Kualifikuar të Shërbimit të Besuar. Ky opsion do të garantonte bazën e duhur ligjore në ofrimin e shërbimeve të besuara, duke vendosur rregulla të qarta për të gjithë palët e përfshira. Ligji i ri nuk përmirëson vetëm aspektin ligjor, por ka ndikim të drejtpërdrejtë në të gjitha nivelet e qeverisjes dhe ndërveprimit digjital, sektor publik, privat dhe qytetarë, duke rritur besueshmërinë dhe efikasitetin e shërbimeve elektronike. Një kuadër ligjor i qartë dhe i harmonizuar me BE-në krijon besim tek investitorët dhe përdoruesit, duke nxitur krijimin e bizneseve dhe përdorimin e shërbimeve digjitale, përfshirë transaksionet ndërkufitare. Gjithashtu hartimi i një ligji të ri ka kosto të konsiderueshme, krahasuar me opsionet e tjera të marra në konsideratë. Edhe pse kosto fillestare është e lartë, përfitimet afatgjata përfshijnë zvogëlimin e barrës administrative, përmirësimin e sigurisë digjitale dhe integrimin më të shpejtë me tregun e BE-së.

Pra ky opsion përfaqëson alternativën e përzgjedhur dhe më të favorshme në drejtim të përmbushjes së objektivave strategjike dhe rregullatore.

Avantazhe: Qartësi normative, përafrim i plotë me standardet e BE-së, vendosje e bazave për njohje ndërkufitare dhe ndërtim i një sistemi të besuar dhe të sigurt digjital. I përgjigjet kërkesave të kohës dhe nevojave të tregut.

Disavantazhe: Ka një kosto të konsiderueshme fillestare për hartimin, miratimin dhe zbatimin e kuadrit të ri, si dhe për ngritjen e strukturave mbështetëse institucionale dhe teknike. Megjithatë, këto kosto justifikohen nga përfitimet afatgjata dhe ndikimi sistemik pozitiv.

Opsioni 3 - Investimi në zgjidhje teknologjike për përdorimin e identifikimit elektronik në distancë
Synimi është mundësimi i zgjidhjeve të krijuara nga subjekte shqiptare për identifikimin elektronik në distancë për qytetarët dhe bizneset në Shqipëri. Ky opsion do të zgjidhte problemin e identifikuar nga sektori privat për mungesën e ofruesve të këtij shërbimi në vend.

Avantazhe: Lehtësi në marrjen e shërbimit me kosto optimale, duke shmangur nevojën për marrjen e këtij shërbimi nga ofrues që operojnë në Bashkimin Evropian.

Disavantazhe: Ky opsion do të zgjidhte pjesërisht vetëm një problematikë të identifikuar në zbatimin e legjislacionit ekzistues dhe nuk do të njihej efekti i tij ligjor, pasi mungojnë parashikimet përkatëse në legjislacionin në fuqi për mënyrën e ofrimit të identifikimit elektronik në distancë.

Vlerësimi i opsioneve/analizimi i ndikimeve

1. *Identifikoni grupet e prekura.*
2. *Identifikoni llojet e ndikimeve për secilin grup të prekur, bëni dallimin midis ndikimeve të drejtpërdrejta dhe jo të drejtpërdrejta.*
3. *Për ndikimet e drejtpërdrejta:*
 1. *Përshkruani nga ana cilësore ndikimet e drejtpërdrejta mbi grupet e prekura.*
 2. *Analizoni nga ana sasore ndikimet më të rëndësishme të drejtpërdrejta.*
 3. *Përcaktoni vlerën monetare të ndikimeve më të rëndësishme të drejtpërdrejta aty ku është e mundur (përdor tabelën në Aneksin 2/a të këtij dokumenti).*
 4. *Analizoni ndikimin mbi ndërmarrjet e vogla dhe të mesme (nëse ka).*
4. *Për ndikimet jo të drejtpërdrejta:*
 1. *Përshkruani nga ana cilësore ndikimet jo të drejtpërdrejta mbi grupet e prekura.*
 2. *Analizoni ndikimin mbi konkurrencën.*
5. *Diskutoni kufizimin e analizës:*
 1. *Jepni supozimet në të cilat janë bazuar parashikimet dhe risqet, të cilave ato u nënshtrohen.*
 2. *Tregoni se çfarë mund të pengojë realizimin e përfitimeve, të rrisë kostot ose të sjellë pasoja të papritura.*
6. *Përmbledhni vlerësimin e opsioneve:*
 1. *Paraqisni një pasqyrë përmbledhëse të të gjitha ndikimeve të opsioneve të analizuara.*
 2. *Shpjegoni se si ndikimet e të gjitha opsioneve të analizuara krahasohen me njëra-tjetrën.*
 3. *Paraqisni përllogaritetet më të mira të përgjithshme neto të ndikimit me vlerë monetare të përcaktuar për çdo opsion (përdor tabelën në Aneksin 2/b të këtij dokumenti).*

Grupet e prekura: Miratimi i një projektligji të ri për fushën e identifikimit elektronik dhe shërbimet e besuara do të ketë një impakt pozitiv tek qeveria, ofruesit e kualifikuar të shërbimit të besuar në Republikën e Shqipërisë, qytetarët, bizneset, sektori publik, pasi do të përmirësojë ofrimin e shërbimeve të besuara si dhe do të rrisë sigurinë për transaksionet elektronike në tregun e brendshëm duke siguruar një bazë të përbashkët për bashkëveprim të sigurt elektronik midis qytetarëve, bizneseve dhe autoriteteve publike. Përmes forcimit të standardeve të sigurisë dhe lehtësimit të procedurave në ofrimin e shërbimeve, rrit efektivitetin, integritetin, sigurinë dhe besueshmërinë në ofrimin e shërbimeve të besuara dhe portofolit të identitetit digjital në Republikën e Shqipërisë. Ky projektligj adreson dhe zgjidh problematikat aktuale, duke plotësuar mangësitë në kornizën ligjore në fushën e identifikimit elektronik dhe shërbimeve të besuara. Përmes lehtësimit të procedurave të pajisjes me mjete të identifikimit elektronik të aplikuesit, shkurton kohën dhe shmang barrierat administrative. Po ashtu, duke konsideruar angazhimet e qeverisë shqiptare në kuadër të integritetit evropian, përmbush objektivin në lidhje me procesin e përafrimit të legjislacionit të BE-së në fushën e identifikimit elektronik dhe shërbimeve të besuara. Një qasje të unifikuar dhe të besueshme ndaj identitetit elektronik.

Ofruesit jo të kualifikuar të shërbimit të besuar janë një kategori tjetër që do të preket nga zbatimi i këtij ligji, nëpërmjet të cilit janë vendosur rregulla lidhur me ushtrimin e vprimtarisë së tyre si dhe mbikëqyrjes së tyre.

Gjithashtu do të preken nga zbatimi i ligjit edhe organet e vlerësimit të konformitetit (OVK), si subjekte të këtij ligji duke e ushtruar veprimtarinë e tyre konform kërkesave të përcaktuara në këtë ligj.

Shënim: Neni 4, pika 29 e projektligjit përcakton se “Organe të vlerësimit të konformitetit” janë organet kompetente të cilët kryejnë aktivitete të vlerësimit të konformitetit duke përfshirë kalibrimin, testimin, certifikimin dhe inspektimin, të akredituara sipas legjislacionit në fuqi për akreditimin i cili kryen vlerësimet e konformitetit të veprimtarisë së një Ofruesi të Kualifikuar të Shërbimit të Besuar ose shërbimeve të besuara të ofruara prej tij ose certifikimin e Portofolit të Identitetit Digjital ose të mjeteve të identifikimit elektronik;

Ndikimet për **qeverinë** janë si më poshtë:

Ndikime të drejtpërdrejta :

- Përbushja e detyrimeve në kuadër të përafrimit të legjislacionit me acquis, duke arritur përafrim të plotë.
- Përmirësimi i ofrimit të shërbimeve të besuara në vend duke garantuar autenticitetin, integritetin, sigurinë dhe besueshmërinë e përdorimit të shërbimeve të identifikimit elektronik dhe shërbimeve të besuara, duke arritur që shërbimet e ofruara të përmbushin standardet përkatëse të sigurisë në masën 100%.
- Lehtësimi i procesit të pajisjes me mjete të identifikimit elektronik duke ulur kohën mesatare, duke rritur me numrin e përdoruesve brenda 2 viteve dhe duke mundësuar që të paktën 70% e aplikimeve të kryhen online.
- Gjenerimi i të ardhurave shtesë në buxhetin e shtetit duke qenë ligji përcakton tarifa në kuadër të ushtrimit të veprimtarisë së subjekteve të këtij ligji duke sjellë ndikim pozitiv në buxhetin e shtetit dhe për rrjedhojë edhe në ekonominë e vendit.

Ndikime jo të drejtpërdrejta:

- Garantimi i një mjedisi neutral për nga pikëpamja teknologjike për ofruesit e shërbimeve të besuara.
- Rritja e bashkëpunimit midis ofruesve të kualifikuar të shërbimeve të besuara me institucione shtetërore dhe private, nëpërmjet skemave të identifikimit elektronik të sigurt, me qëllim autentifikimin e personave fizikë apo juridikë.

Ofruesit e Kualifikuar të shërbimeve të besuara do të preken nga ndërmarrja e kësaj politike, duke ndikuar në përmirësimin e ofrimit të shërbimeve të tyre por nga ana tjetër do të rriten kërkesat e sigurisë në ofrimin e këtyre shërbimeve duke qenë se ligji parashikon përcaktimin e metodave të reja të identifikimit elektronik, pajisjet e krijimit të nënshkrimit elektronik dhe vulës elektronike duke forcuar kërkesat e sigurisë, gjë e cila nënkupton më shumë investime nga ana e tyre. Kjo pjesë nuk mund të llogaritet pasi mbetet në vlerësim të ecurisë së zbatimit dhe përshtatjes me këtë ligj.

Gjithashtu edhe **bizneset, qytetarët, administrata publike** do të shohin një përmirësim të dukshëm në përdorimin e shërbimeve të besuara si dhe të proceseve administrative në lidhje me ofrimin e këtyre shërbimeve, pasi siç u përmend edhe më sipër do të përmirësohet ofrimi i shërbimeve të besuara në vend si dhe me përcaktimin e metodave të reja të identifikimit do të shkurtohet distanca dhe do të lehtësohet ky proces. Gjithashtu do të kemi një rritje të bashkëpunimit dhe ndërveprimit të skemave të identifikimit

elektronik duke lehtësuar ofrimin ndërkufitar të shërbimeve dhe duke i mundësuar bizneseve të operojnë në baza ndërkufitare pa u përballur me shumë pengesa në ndërveprimet me autoritetet publike.

Ndikimet financiare

Kosto: Efektet financiare negative për Buxhetin e shtetit për ata OKSHB që financohen nga Buxheti i Shtetit, në kuadër të investimeve që do të duhet të bëjnë me qëllim përmbushjen e masave të sigurisë, duke qenë se ligji përcakton rritjen e këtyre masave të cilat kërkojnë investime në teknologji dhe në rritjen e kapaciteteve si dhe përmbushjen e detyrimeve që ligji vendos (raporti i vlerësimit të konformitetit, certifikimi pajisjeve etj).

Gjithashtu krijimi dhe funksionimi i Portofolit të Identitetit Digjital (nëse do të bëhet nga një subjekt shtetëror) kërkon investime të konsiderueshme në infrastrukturë, teknologji dhe kapacitete njerëzore, çka përbën një ngarkesë financiare për buxhetin në fazat fillestare të zbatimit të ligjit.

Përfitime në buxhetin e shtetit: Miratimi i këtij projektligji parashikohet të ketë efekte financiare pozitive në buxhetin e shtetit duke sjellë përfitime lidhur me tarifën për regjistrimin si ofrues të kualifikuar të shërbimit të besuar, organe të vlerësimit të konformitetit. Përcaktimi i këtyre tarifave do të bëhet me vendim të Këshillit të Ministrave duke pasqyruar ndikim pozitiv në buxhetin e shtetit dhe për rrjedhojë edhe në ekonominë e vendit.

Ndikimet sociale:

- a) Rritja e besueshmërisë tek publiku lidhur me përdorimin e shërbimeve të identifikimit elektronik dhe shërbimeve të besuara dhe si rrjedhojë rritja e numrit të përdoruesve të tyre me të paktën 50% brenda dy viteve, si rezultat i përmirësimit të ofrimit të shërbimeve të besuara që përmbushin standardet përkatëse të sigurisë në masën 100%;
- b) Rritja e sigurisë së transaksioneve elektronike në tregun e brendshëm, duke siguruar që transaksionet të kryhen përmes sistemeve të certifikuara dhe duke rritur përdorimin e platformave të ndërveprueshme midis qytetarëve, bizneseve dhe autoriteteve publike;
- c) rritja e transparencës dhe besueshmëri më e lartë në lidhje me ofrimin e shërbimeve të kualifikuara të besuara duke publikuar listat përkatëse të ofruesve të kualifikuar të shërbimeve të besuara, pajisjeve të certifikuara për krijimin e nënshkrimit elektronik të kualifikuara, etj;
- d) mundësimin që qytetari të ketë kontroll të plotë në të dhënat personale në portofolin e identitetit digjital duke ofruar të gjitha funksionalitetet për ndarjen selektive të të dhënave, raportimin e kërkesave të supozuara të paligjshme ose të dyshimta në lidhje me të dhënat, etj.;
- e) akses të barabartë në shërbime dhe ofrimi i shërbimeve të standardizuara për të gjithë qytetarët, duke bërë që shërbimet të jenë të disponueshme për të gjithë qytetarët, duke ulur diferencat e aksesueshmërisë në bazë gjinore, racore, krahinore, aftësish digjitale, etj.;
- f) edukimi i përdoruesve, duke trajnuar qytetarët dhe duke realizuar fushata ndërgjegjësimi, duke qenë se implementimi i rregullores së re eIDAS kërkon që qytetarët të mësojnë të përdorin mjete të reja si nënshkrim elektronik, identifikim me portofolin digjital etj.

Arsyetimi i opsionit të preferuar

1. Zgjidhni opsionin e preferuar, bazuar në analizë.
2. Shpjegoni arsyetimin tuaj.

Opsioni i preferuar është përzgjedhur opsioni 2 - hartimi dhe miratimi i një ligji të ri “Për identifikimin elektronik, shërbimet e besuara dhe portofoli i identitetit digjital” pasi përmirëson dhe rrit sigurinë, efektivitetin, integritetin, në ofrimin e shërbimeve të besuara duke garantuar besueshmërinë në përdorimin e tyre nga qytetarët, bizneset dhe administrata publike, për të hyrë në shërbimet online ose për të menaxhuar transaksionet elektronike në vend.

Zbatimi i këtij opsioni garanton :

- (a) Adreson dhe zgjidh problematikat aktuale. Projektligji plotëson mangësitë në kornizën ligjore dhe ju jep zgjidhje problematikave ekzistuese në fushën e identifikimit elektronik dhe shërbimeve të besuara.
- (b) Përbush të gjitha objektivat e shpjeguara për sa më sipër duke rritur sigurinë e transaksioneve elektronike në vend, përmes rritjes së përdorimit të identifikimit elektronik dhe shërbimeve të besuara të kualifikuara në përputhje të plotë me kërkesat e sigurisë të përcaktuara në ligj.
- (c) Rrit sigurinë në veprimtarinë e ofruesve të kualifikuar të shërbimeve të besuara nëpërmjet forcimit të kërkesave të sigurisë, kontrollit dhe mbikëqyrjes, duke kryer kontrole për secilin ofrues sipas nevojës, të paktën një herë në vit.
- (d) Rrit sigurinë, efektivitetin, integritetin dhe besueshmërinë në ofrimin dhe përdorimin e shërbimeve të besuara, duke arritur që shërbimet e ofruara të përbushin standardet përkatëse të sigurisë në masën 100%.
- (e) Lehtëson procedurat e pajisjes me mjete të identifikimit elektronik të aplikuesit duke shkurtuar kohën.
- (f) Përbush objektivin në lidhje me procesin e përafrimit të legjislacionit të BE-së në fushën e identifikimit elektronik dhe shërbimeve të besuara, duke arritur përafrim të plotë.
- (g) Mundëson qasje të unifikuar dhe të besueshme ndaj identitetit digjital, ku ofruesit zbatojnë të njëjtat standarde, rrjedhimisht duke forcuar sigurinë, privatësinë dhe besimin në shërbimet digjitale publike dhe private.

Ky vlerësim rezulton edhe nga analiza e kosto – përfitimit, kosto – efektivitetit dhe analiza me shumë kritere, pasqyruar më poshtë si vijon:

Analiza e kosto – përfitimit (e pjesshme)

Grupet e prekura janë qeveria, ofruesit e kualifikuar të shërbimit të besuar, organet e vlerësimit të konformitetit (OVK), qytetarët, bizneset, sektori publik.

Sipas opsioni 0 nuk ka kosto të shtuara monetare për të gjithë grupet e prekura pasi nuk kryhet ndonjë ndërhyrje dhe situata mbetet siç është.

Sipas opsionit 1, rriten kostot pasi shtohen masat që duhet të ndërmerren me qëllim rritjen e sigurisë për ushtrimin e veprimtarisë përkatëse të subjekteve të këtij ligji, por përsëri problemi ngelet i paadresuar. Gjithashtu këto opsione mbartin edhe kosto të tjera të cilat prekin qytetarët, bizneset, administratën lidhur me mundësinë e marrjes së këtyre shërbimeve në një kohë sa më efektive dhe sa më të sigurt. Pra kostot lidhen drejtpërdrejtë me mungesën e parashikimeve ligjore referuar metodave të identifikimit të sigurt në distancë, transparencës dhe sigurisë në transaksionet elektronike.

Sipas opsionit 2 kostoja përbëhet nga efekte financiare për OKSHB pasi duhet të rrisin kërkesat e sigurisë në ofrimin e shërbimeve të tyre. Ligji parashikon përcaktimin e metodave të reja të identifikimit elektronik në distancë apo të tjera, gjë e cila nënkupton investime më shumë dhe rritje e kërkesave të sigurisë për të arritur një identifikimin sa më të saktë të aplikuesit dhe për të eliminuar sulmet keqdashëse që cenojnë identitetin e tij. Rritja e kërkesave të sigurisë në përputhje me standardet evropiane të pajisjeve të certifikimit të vlefshmërisë së krijimit të nënshkrimit/vulës elektronike ku këto pajisje duhet të certifikohen nga një OVK, përdorimi i produkteve dhe sistemeve të përshtatshme, punësimi i një stafi me trajnimet e duhura, ofrimi i shërbimit të vlefshmërisë dhe i ruajtjes së nënshkrimit/ vulës elektronike të kualifikuar nëpërmjet përdorimit të procedurave dhe teknologjive të nevojshme, për të rritur besueshmërinë e nënshkrimit/vulës elektronik të kualifikuar përtej periudhës së vlefshmërisë teknologjike. Megjithatë është e pamundur të bëhet vlerësimi në para i këtyre investimeve për ofruesit e kualifikuar të shërbimit të besuar pasi nuk mund të llogariten si dhe duhet parë ecuria e zbatimit të këtij ligji. Gjithashtu krijimi dhe funksionimi i Portofolit të Identitetit Digjital (nëse do të bëhet nga një subjekt shtetëror) kërkon investime të konsiderueshme në infrastrukturë, teknologji dhe kapacitete njerëzore, çka përbën një ngarkesë financiare për buxhetin në fazat fillestare të zbatimit të ligjit.

Opsionet 0, 1 nuk sjellin kosto për Buxhetin e Shtetit.

Për sa i përket opsionit 2, si më i preferuari, sjell kosto në Buxhetin e Shtetit si dhe përfitime financiare duke qenë se ky projektligj zgjeron subjektet e këtij ligji.

Kostot

Një nga risitë kryesore që ky projektligj sjell është Portofoli i Identitetit Digjital, i cili përfaqëson një komponent thelbësor të infrastrukturës kombëtare të identitetit elektronik.

Bazuar në përcaktimet e Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 621, datë 10.10.2024, “Për miratimin e dokumentit të politikës ‘Agjenda Kombëtare e Reformave 2024–2027’, në kuadër të instrumentit të Bashkimit Evropian “Faciliteti për Reforma dhe Rritje për Ballkanin Perëndimor”, Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit (AKSHI) është përcaktuar si institucioni përgjegjës për ndërtimin dhe funksionimin e këtij portofoli.

Në vijim të këtij përcaktimi, Autoriteti Kombëtar për Sigurinë Kibernetike (AKSK), me shkresën nr. 2460 prot., datë 28.08.2025, i është drejtuar AKSHI-t me kërkesën për të paraqitur një përlllogaritje të përafërt të kostove që do të shoqërojnë ngritjen dhe mirëmbajtjen e Portofolit të Identitetit Digjital. AKSHI, me shkresën përkatëse nr. 3916/1 prot., datë 16.10.2025, ka kthyer përgjigje duke përcjellë informacion mbi investimet ekzistuese në infrastrukturën PKI, si dhe një përlllogaritje indikative të kostove për një periudhë 10-vjeçare.

Sipas të dhënave të përcjella nga AKSHI, kostot e përafërta për një periudhë 10-vjeçare janë si më poshtë:

Emërtimi	Kostoja totale (me TVSH)
Kosto e mirëmbajtjes për 10 vitet e ardhshme	271,610,925 ALL
Certifikime ISO 9001:2015, ISO 20000-1:2018, ISO 27001:2022 dhe përputhje me Rregulloren eIDAS (për 10 vite)	431,836,560 ALL
Totali	703,447,485 ALL

Përlllogaritja është kryer duke marrë në konsideratë kostot e mirëmbajtjes për një periudhë dyvjeçare, si dhe certifikimet ISO, me përsëritje çdo dy vite, si më poshtë:

- Kosto mirëmbajtje (2 vite): $54,322,185 \text{ ALL} \times 5 = 271,610,925 \text{ ALL}$ (10 vite);
- Kosto certifikimesh ISO dhe eIDAS (2 vite): $86,367,312 \text{ ALL} \times 5 = 431,836,560 \text{ ALL}$ (10 vite).

Totali i përafërt i përlllogaritur për një periudhë 1 vjeçare është 70,344,748.5 ALL me TVSH ndërsa për periudhën 10-vjeçare është 703,447,485 ALL me TVSH.

Duhet theksuar se këto përlllogaritje janë indikative dhe bazohen në kostot aktuale të infrastrukturës ekzistuese dhe certifikimeve në fuqi. Në vlerësimin financiar nuk janë përfshirë elemente të mundshme shtesë si:

- shtimi i kapaciteteve njerëzore për administrimin e portofolit,
- investime të reja në teknologjinë hardware dhe software,
- si dhe kosto të tjera që mund të rrjedhin nga certifikime shtesë ISO ose kërkesat e reja të rregullores eIDAS në vazhdimësi.

Në këtë kuptim, përlllogaritjet e mësipërme shërbejnë si indikator orientues për vlerësimin e ndikimit financiar të këtij komponenti të ri të projektligjit të cilat mund të ndryshojnë në vijim.

Në një perspektivë afatgjatë, këto kosto duhet të konsiderohen si investim strategjik për garantimin e sigurisë, integritetit dhe besueshmërisë së identitetit elektronik të qytetarëve, si dhe për forcimin e arkitekturës së shërbimeve digjitale në nivel kombëtar.

Përfitimet

Referuar kuadrit ligjor aktual, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr.503 datë 13.5.2009 “Për miratimin e pagesave që kryhen në Autoritetin Kombëtar për Çertifikimin Elektronik”, i ndryshuar, përcakton tarifat përkatëse në lidhje me regjistrimin e OKSHB, OTK si dhe vlerësimin periodik, si më poshtë vijon:

- Regjistrim i Ofruesit të kualifikuar të shërbimit të besuar, vlera e përcaktuar 20,000 lekë (periodicitetit i pagesës njëvjeçar)
- Regjistrim i Organizmit të Testimit e Konfirmimit (me ligjin e ri emërtimi OVK, organe të vlerësimit të konformitetit, janë po të njëjtët vetëm se emërtimi është bërë në përputhje me emërtimin është riformuluar njëjtë me përcaktimet e rregullores eIDAS), vlera e përcaktuar 20,000 lekë (periodicitetit i pagesës njëvjeçar).
- Vlerësim periodik, vlera e përcaktuar 10,000 lekë (periodicitetit i pagesës njëvjeçar)

Për sa më sipër rezulton se gjatë një viti do të depozitohet tarifa e regjistrimit të ofruesve të kualifikuar të shërbimit të besuar 20,000 lekë, ($20,000 \times 1$ që janë aktualisht OKSHB = 20,000 lekë) si dhe vlera e vlerësimit periodik 10,000 lekë ($10,000 \times 1 = 10,000$ lekë).

Aktualisht është 1 (një) OKSHB të regjistruar në Republikën e Shqipërisë. Vlen të sqarohet se shembulli i marrë sa më sipër është marrë në analogji me situatën aktuale pasi varet edhe nga numri i OKSHB-ve, OVK-ve që do regjistrohen në vazhdim.

Kostoja e përlllogaritur me sa më sipër përgjatë një viti për një OKSHB do të jetë 30,000 lekë, (regjistrim + vlerësimi periodik). Kjo kosto për biznesin përkethehet në përfitime direkte e të ardhurave në Buxhetin e Shtetit.

Pavarësisht se Opsioni 2 ka kosto më të konsiderueshme se opsioni 1 duke qënë se rrit kërkesat e sigurisë dhe kjo nënkupton më shumë investime, miratimi i një ligji të ri, është më i përshtatshëm nga pikëpamja legjislative si dhe i'u jep zgjidhje të gjitha problematikave të evidentuara në fushën e identifikimit elektronik dhe shërbimeve të besuara duke përmbushur të gjitha objektivat dhe duke rritur sigurinë në transaksionet elektronike në vend.

Për sa më sipër përveç përfitimeve në Buxhetin Shtetit gjithashtu një impakt të konsiderueshëm do të kenë edhe investimet që do të duhet të bëjnë këto subjekte referuar aplikimit të kërkesave të sigurisë, por kjo nuk mund të parashikohet në një vlerë monetare fikse dhe si pasojë nuk mund të kryhet analiza e plotë e kosto-përfitimit .

Vlen të përmendet që këto tarifa do të ndryshojnë me miratimin e ligjit të ri duke marrë në konsideratë inspektimet dhe kontrollet e kryera, vlera e të cilave do të përcaktohet me vendim të Këshillit të Ministrave.

Bashkëlidhur raporti i vlerësimit të ndikimit për ofruesit e kualifikuar të shërbimit të besuar - Shtojca 2/b.

Analiza kosto – efektivitetit

Sipas analizës së kosto-efektivitetit opsionet 0 dhe 1, janë opsionet me më shumë kosto. Sipas opsionit 0 nuk ndërhyhet me ndryshim politike, gjë e cila do të sjellë si kosto krijimin e mangësive ligjore për shumë çështje të cilat nuk janë të rregulluara aktualisht si dhe mosadresimin e problematikave aktuale .

Sipas opsionit 1 pavarësisht se do të kemi rritjen e investimeve në përmbushjen e detyrimeve për ushtrimin e veprimtarisë së OKSHB, por nuk do të kishim adresim të problematikave aktuale lidhur përmirësimin e ofrimit të shërbimeve të besuara, garantimin e besueshmërisë dhe sigurisë në përdorimin e shërbimeve të identifikimit elektronik dhe shërbimeve të besuara nga qytetarët, bizneset dhe administrata publike, për të hyrë në shërbimet online ose për të menaxhuar transaksionet elektronike në vend. Gjithashtu nga pikëpamja legjislative ndryshimet e reflektuara në përmbajtjen e projektligjit kalojnë 50% .

Për të dyja opsionet e sipërpërmendura kjo kosto do të rëndojë mbi të gjitha grupet e prekura.

Opsioni nr. 2 sjell kosto financiare në buxhetin e shtetit (lidhur me ngritjen dhe funksionimin e Portofolit të Identitetit Digjital, siç është përlllogaritur në faqen 16 të këtij dokumenti si shembull) si dhe njëkohësisht garanton përmbushjen e objektivave të analizuara më sipër (*Pjesa I*) . Gjithashtu sjell përfitime financiare në buxhetin e shtetit referuar tarifës së regjistrimit dhe vlerësimit periodik të subjekteve të këtij ligji. Sigurisht që ka impakt financiar në veprimtarinë e OKSHB duke qenë se shton dhe forcon kërkesat për ushtrimin e veprimtarisë së tyre, por që nuk mund të përcaktohen në vlerë monetare, pasi duhet parë ecuria dhe përshtatshmëria pas hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Analiza me shumë kritere

Opsionet që merren në konsideratë janë:

Opsioni 0 – status *quo-ja* dhe mosbërja e ndryshimeve ligjore, duke pritur që situata të vetë rregullohet, pa ndërhyrjen e pushtetit legjislativ.

Opsioni 1 – Kryerja e ndërhyrjeve ligjore, duke ndryshuar ligjin nr.107/2015 “Për Identifikimin Elektronik dhe Shërbimet e Besuara”, i ndryshuar, dhe Ligji nr.9880/2008 “Për nënshkrimin elektronik”, i ndryshuar.

Opsioni 2 – Miratimi i një ligji të ri në fushën e identifikimit elektronik dhe shërbimeve të besuara i cili do të plotësonte kuadrin ligjor aktual dhe do adresonte problematikat ekzistuese.

Opsioni 3 - Investimi në zgjidhje teknologjike për përdorimin e identifikimit elektronik në distancë.

Kriteret për vlerësimin e opsioneve dhe pesha e secilit sipas rëndësisë relative:

1. Qartësia juridike dhe adresimi i problematikave ekzistuese – 5
2. Rritja e transparencës në ofrimin e shërbimeve nga Ofruesit e Kualifikuar të Shërbimit të Besuar nëpërmjet rritjes së kërkesave të sigurisë, kontrollit dhe mbikëqyrjes – 4
3. Garantimi i transaksioneve elektronike të sigurta në vend duke rritur efektivitetin, integritetin, sigurinë dhe besueshmërinë në ofrimin e shërbimeve të besuara - 4
4. Rritja e sigurisë dhe besueshmërisë në identifikimin elektronik përmes përdorimit të Portofolit të Identitetit Digjital -5
5. Lehtësimi i procedurës së pajisjes me mjete të identifikimit elektronik të aplikuesit nëpërmjet përcaktimit të metodave të tjera të identifikimit elektronik (në distancë) - 5
6. Garantimi i një mjedisi neutral për nga pikëpamja teknologjike për ofruesit e kualifikuar të shërbimeve të besuara në ofrimin e shërbimeve të tyre. -3
7. Kostot-Efektiviteti - 5

Shkalla e performancës është nga 0 në 5, ku 0 përfaqëson opsionin më pak të preferuar dhe 5 atë më të preferuarin .

Kriteret	Pesha	Opsioni 0	Opsioni 1	Opsioni 2	Opsioni 3
Qartësia juridike dhe adresimi i problematikave ekzistuese	5	0 (0)	2 (10)	4 (20)	1 (5)
Rritja e transparencës në ofrimin e shërbimeve nga Ofruesit e Kualifikuar të Shërbimit të Besuar nëpërmjet rritjes së kërkesave të sigurisë, kontrollit dhe mbikëqyrjes.	4	1 (4)	1 (4)	2 (8)	0 (0)
Garantimi i transaksioneve elektronike të sigurta në vend duke rritur efektivitetin, integritetin, sigurinë dhe besueshmërinë në ofrimin e shërbimeve të besuara.	4	2 (8)	2 (8)	3 (12)	0 (0)
Rritja e sigurisë dhe besueshmërisë në identifikimin elektronik përmes përdorimit të Portofolit të Identitetit Digjital	5	0 (0)	1 (5)	3 (15)	0 (0)
Lehtësimi i procedurës së pajisjes me mjete të identifikimit elektronik të aplikuesit nëpërmjet përcaktimit të metodave të tjera të identifikimit elektronik (në distancë).	5	0 (0)	2 (10)	3 (15)	2 (10)
Garantimi i një mjedisi neutral për nga pikëpamja teknologjike për ofruesit e kualifikuar të shërbimeve të besuara në ofrimin e shërbimeve të tyre.	3	1 (0)	1 (3)	3 (9)	0 (0)
Kostot - Efektiviteti	5	2 (10)	3 (15)	4 (20)	0 (0)
Pikët		22	55	99	15

Për sa më sipër, analiza kosto-përfitim, kosto – efektivitet opsionet 0, 1, passjellin përfitime në buxhetin e shtetit duke qenë se në ligj përcaktohet pagsa e tarifave përkatëse lidhur me veprimtarinë e OKSHB, OVK. Opsioni 0 dhe opsioni 3 nuk u japin zgjidhje problematikave aktuale, ndërsa opsioni 1 sipas teknikës legjislative ndryshimet e reflektuara kalojnë 50 % të përmbajtjes së tij.

Ndërsa opsioni 2 shihet si më i përshtatshëm pasi adreson problematikat aktuale, rregullon mangësitë ligjore, zgjeron rrethin e subjekteve të këtij ligji si dhe passjell përfitime në buxhetin e shtetit.

Sipas analizës me shumë kritere, hartimi dhe miratimi i një ligji të ri për identifikimin elektronik dhe shërbimet e besuara merr më shumë pikë në krahasim me opsionet e tjera.

Çështje të zbatimit

1. *Shpjegoni se cila strukturë do të jetë përgjegjëse për zbatimin e opsionit të zgjedhur.*
2. *Shpjegoni pengesat e mundshme për zbatimin e opsionit të zgjedhur.*
3. *Përshkruani masat që do të ndërmerren gjatë zbatimit për të arritur qëllimet e politikës.*

Pas hyrjes në fuqi të projektligjit “Për identifikimin elektronik, shërbimet e besuara dhe portofoli i identitetit digjital”, subjektet përgjegjëse për zbatimin dhe monitorimin e projektligjit janë Autoriteti Kombëtar për Sigurinë Kibernetike, organet publike, Ofruesit e Kualifikuar të Shërbimit të Besuar, Organet e Vlerësimit të Konformitetit, organi përgjegjës për ofrimin e portofolit, ofruesit jo të kualifikuar të shërbimit të besuar. Zbatimi i plotë dhe efektiv i projektligjit varet nga nxjerrja dhe miratimi i akteve nënligjore në bazë e për zbatim të këtij ligji. Autoritetet shtetërore që synohen të ngarkohen me miratimin e tyre janë Drejtori i Përgjithshëm i Autoritetit për një pjesë të akteve, si dhe Këshilli i Ministrave për rregullimin e çështjeve më të rëndësishme që kërkojnë vullnet më të gjerë politik për sanksionimin ligjor të tyre. Miratimi i këtyre akteve nënligjore synohet të bëhet brenda një periudhe prej 24 muajsh nga hyrja në fuqi e ligjit, kohë të cilën e çmojmë të mjaftueshme për hartimin e akteve nënligjore normative cilësore dhe shteruese për aq sa ligji autorizon.

Përzgjedhja e opsionit të preferuar-hartimi i një ligji të ri për identifikimin elektronik dhe shërbimet e besuara mund të shoqërohet me pengesa, të cilat identifikohen kryesisht në momentin e fillimit të zbatimit të tij (pas hyrjes në fuqi). **Pengesat kryesore paraqiten në mënyrë të përmbledhur si më poshtë vijon:**

1. Vonesa në nxjerrjen e akteve nënligjore, pra përtej afatit të vendosur në projektligj për miratimin e tyre. Në lidhje me këtë aspekt, sqarojmë se puna për hartimin e akteve nënligjore fillon paralajmërisht me procesin e shqyrtimit dhe miratimit të kësaj nisme nga Kuvendi i Republikës, me qëllim shmangien e kësaj problematikës së vonesës. Megjithatë, mund të ndodhë që hartimi i disa prej akteve nënligjore të jetë kompleks apo i vështirë, nisur nga natyra dhe përmbajtja e çështjeve që duhet të rregullohen sipas delegimeve ligjore respektive. Nga ana tjetër, mund të ndodhë që procesi i konsultimit të tyre të marrë kohë më shumë për shkak të angazhimit të disa palëve në proces, vonesave në dërgimin e mendimit prej tyre, procesit të vazhdueshëm të bashkërendimit deri në rakordimin e qëndrimeve për rregullimin e çështjeve të caktuara.
2. Përshtatja me legjislacionin e ri, për shkak të risive që ky ligj sjell referuar kushteve ligjore, teknike, financiare të OKSHB, mekanizmave të kontrollit, mbikëqyrjes së veprimtarisë së tyre, kërkesave të sigurisë, aplikimit të metodave të reja të identifikimit elektronik.
3. Mungesa e interesit për t’u akredituar si OVK, duke qenë se deri më tani nuk ka organe të tilla të akredituara në Republikën e Shqipërisë.

4. Koha që nevojitet për subjektet e këtij ligji që të përshtaten me rregullat dhe procedurat e vendosura në këtë ligj duke qenë se ligji sjell risi në operimin, ushtrimin e veprimtarisë, ofrimin e shërbimeve, shtim të kërkesave të sigurisë.

Disa prej masave që do të ndërmerren gjatë zbatimit për të arritur qëllimet e politikës janë:

1. Përcaktimi i rregullave të qarta që rregullojnë veprimtarinë e OKSHB (përcaktimi me akte nënligjore).
2. Inspektimet dhe kontrollet periodike të veprimtarisë së OKSHB nga Autoriteti;
3. Vlerësime të veprimtarisë së OKSHB nëpërmjet analizave 6 dhe 12 mujore në bazë të raporteve (vjetore dhe sa herë që kërkohet nga Autoritetit) të dorëzuara .
4. Zhvillimi i fushatave të ndërgjegjësimit, takimeve dhe workshop-eve me grupet e interesit, si ofrues të shërbimeve të besuara, institucione shtetërore, biznese, qytetarë, etj. mbi zbatimin e kërkesave të ligjit dhe promovimin e përdorimit të këtyre shërbimeve.

Faza e monitorimit dhe vlerësimit

4. *Jepni një përshkrim të përmbledhur të masave të monitorimit dhe të vlerësimit.*
5. *Identifikoni kriteret/treguesit për të matur arritjen e objektivave ose progresin drejt tyre.*

Monitorimi i zbatimit të këtij projektligji do të bëhet nga Autoriteti Kombëtar për Sigurinë Kibernetike si institucioni përgjegjës për rregullimin dhe mbikëqyrjen e fushës së identifikimit elektronik dhe shërbimeve të besuara në RSH.

Disa nga indikatorët që do të shërbejnë në vlerësimin e suksesit të zbatimit të politikës dhe vlerësimit të objektivave lidhen me:

1. Numri i akteve nënligjore të miratuara në kuadër të zbatimit të këtij ligji dhe ecuria e përshtatshmërisë.
2. Numri i Portofolave të Identitetit Digjital të zbatuar.
3. Numri i OSHB-ve dhe OKSHB-ve që operojnë në vend;
4. Reduktimi me 50% i mangësive të evidentuara gjatë ushtrimit të veprimtarisë së OKSHB të pasqyruara në raportet e inspektimit, kontrollet periodike dhe raportet e vlerësimit të konformitetit të veprimtarisë së Ofruesve të Kualifikuar të Shërbimeve të Besuara.
5. Koha e marrjes së shërbimit të pajisjes me mjete të identifikimit elektronik;
6. Numri i i OVK dhe organeve të certifikimit të pajisjeve të krijimit të nënshkrimeve dhe vulave elektronike të kualifikuara ë akredituara në Republikën e Shqipërisë, duke qenë se aktualisht nuk ka organe të tillë që të operojnë.
7. Numri i shërbimeve (të marra/përdorura) nga individët/bizneset) ku përdoret nënshkrimi elektronik, vula elektronike, identifikimi elektronik, etj.

Raporti i vlerësimit të ndikimit - Shtojca 2/a

Tabela: Vlera aktuale neto në total (VAN) - kostot dhe përfitimet me vlerë monetare të përcaktuara në milionë lekë e zbritur për 10 vjet (Vlera aktuale e kostos dhe vlera aktuale e përfitimit); krahasuar me status quo-në.

	Viti 1	Viti 2	Viti 3	Viti 4	Viti 5	Viti 6	Viti 7	Viti 8	Viti 9	Viti 10
Faktori zbritës										
Kosto për buxhetin - një herë	703.447485	703.447485	703.447485	703.447485	703.447485	703.447485	703.447485	703.447485	703.447485	703.447485
Kosto për buxhetin - në vazhdimësi										
Kosto për bizneset - një herë										
Kosto për bizneset - në vazhdimësi										
Kosto për grupet e tjera - një herë										
Kosto për grupet e tjera - në vazhdimësi										
Kosto në total										
Kosto e zbritur= Kosto në total x Faktori zbritës										
Përfitimet për buxhetin – një herë										
Përfitimet për buxhetin – në vazhdimësi										
Përfitimet për grupet										

e tjera – një herë										
Përfitimet për grupet e tjera – në vazhdimësi										
Përfitimet për biznesin – një herë										
Përfitimet për biznesin – në vazhdimësi										
Përfitimet totale										
Përfitimi i zbritur= Përfitimi në total x faktori zbritës										
Vlera prezente aktuale e përfitimit në total										
Vlera prezente aktuale e kostos në total										
Vlera Prezente Netë Aktuale (VAN) = Vlera aktuale e përfitimit në total – Vlera aktuale e kostos në total										

***Sqarim:** Së pari, lidhur me koston në buxhetin në vazhdimësi është e pamundur të parashikohet pasi kjo do të varet nga standardet dhe specifikimet teknike që do të miratohen nga Komisioni Evropian dhe do të implementohen përmes akteve nënligjore që do të miratohen në zbatim të këtij ligji në Republikën e Shqipërisë.

Vlerësohet se është praktikisht e pamundur të përlogaritet në mënyrë të saktë një kosto e përgjithshme për biznesin. Kjo lidhet drejtpërdrejt me natyrën specifike të shërbimeve të besuar, të kualifikuara ose jo të kualifikuara, dhe të identifikimit elektronik, të cilat ndryshojnë ndjeshëm nga një ofruer tek tjetri dhe sipas nivelit të besueshmërisë dhe sigurisë. Në mënyrë konkrete, kostoja për secilin subjekt do të varet nga një sërë faktorësh, përfshirë, por pa u kufizuar në: llojin e shërbimit që do të ofrohet në treg, modelin e biznesit të ndjekur, teknologjitë që do të përdoren, niveli i sigurisë që synohet të arrihet, si dhe shkalla e investimeve në infrastrukturë dhe burime njerëzore. Për rrjedhojë, çdo përpjekje për të përcaktuar një kosto standarde apo mesatare do të ishte e pasaktë.

Së dyti, për sa i përket impaktit të drejtpërdrejtë të projektligjit në biznes, theksojmë se aktualisht në treg nuk operojnë subjekte private që ofrojnë shërbime të tilla të kualifikuara në kuptim të këtij projektligji. Në këtë kontekst, projektligji nuk krijon një barrë të menjëhershme apo ndikim të drejtpërdrejtë financiar për bizneset ekzistuese.

Në këtë kuadër, impakti i projektligjit sa i përket biznesit do të jetë kryesisht potencial dhe i lidhur me subjektet që mund të krijohen në të ardhmen për të operuar në këtë treg. Për këto subjekte të reja, projektligji krijon një kornizë rregullatore të qartë dhe të parashikueshme, e cila synon të garantojë siguri juridike dhe teknike, si dhe të nxisë zhvillimin e tregut të shërbimeve të besuara dhe identifikimit elektronik.

Për të njëjtat arsye të përmendura më sipër, është e pamundur të vlerësohen edhe përfitimet në këtë fazë, pasi kjo do të varet nga numri i subjekteve që do të operojnë në treg, shërbimet që do të ofrojnë dhe tarifat e tyre, si dhe shkalla e përdorimit të këtyre shërbimeve.

Në përfundim, vlerësojmë se projektligji nuk ka impakt të drejtpërdrejtë mbi bizneset ekzistuese, si dhe kostoja për buxhetin dhe përfitimet në vazhdimësi janë të pamundura të llogariten pasi lidhet me vendimmarrjen e subjekteve të reja për të hyrë në treg, shërbimet specifike të ofruara prej tyre në përputhje me kërkesat ligjore dhe ecurinë e tregut në vazhdimësi.

Raporti i vlerësimit të ndikimit - Shtojca 2/b

Tabelë: Vlera aktuale neto në total e çdo opsioni

Opsioni	Vlera aktuale në lekë		Vlera aktuale neto në lekë
	Kosto	Përfitimi	
Opsioni 1	-	30,000 lekë	30,000 lekë
Opsioni 2	-	30,000 lekë	30,000 lekë

Shënim: Përlogaritja është bërë vetëm për një OKSHB.

Duhet të meren në konsideratë tarifat e reja që do të përcaktohen si edhe organet e reja që do të akreditohen.

KRYEMINISTRI

[Emri Mbiemri]